



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°9/2022

Hagë, 10/03/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, më 3 mars ZPS-ja dorëzoi dosjen gjyqësore përfundimtare. Deklaratat përmbyllëse të palëve janë planifikuar të mbahen nga data 14 deri më 18 mars, duke filluar në orën 9 :30.

Gjatë deklaratave përmbyllëse, palët do të përpiqen të nënvizojnë aspektet më të rëndësishme të çështjeve të tyre dhe anëtarët e Trupit Gjykues mund t'u bëjnë disa pyetje. Të akuzuarit kanë të drejtën të flasin të fundit dhe deklaratat e tyre janë planifikuar për datën 18 mars.

Më 7 mars, Kryetarja Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e apelit të z. Nasim Haradinaj kundër vendimit të Trupit Gjykues II lidhur me vazhdimin e paraburgimit të tij. Paneli përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Në çështjen *Salih Mustafa*, më 8 dhe 9 mars u mbajt konferenca përgatitore e Mbrojtjes së bashku me konferencën lidhur me viktimat, për të diskutuar hapat e ardhshëm të procesit.

Trupi Gjykues shqiptoi disa urdhra gojorë për këtë çështje, midis të cilëve edhe caktimin e datës 22 mars si datën për deklaratat hyrëse të Mbrojtjes, dhe datën 23 mars për fillimin e dëshmisë së dëshmitarit të parë të Mbrojtjes. Mbrojtjes i janë caktuar 36 orë gjithsej për pyetjet që do t'u bëjë 17 dëshmitarëve të saj që janë autorizuar të dëshmojnë.





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°9/2022

Hagë, 10/03/2022

Trupi Gjykes më tej autorizoi viktimën 05 që më 21 mars, në orën 9:30 të shprehë mendimet dhe shqetësimet e veta para Trupit Gjykes, për një orë. Identiteti i viktimës do të mbahet konfidencial për publikun.

Gjithashtu, Trupi Gjykes caktoi Institutin Holandez të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin mjekësor të dëmtimeve dhe lëndimeve psikiatrike dhe fizike që kanë pësuar tri viktima dhe i kërkoi që të përgatisë raportin përkatës. Raporti do t'i dorëzohet Trupit Gjykes brenda datës 13 maj dhe nuk kushtëzon vendimin përfundimtar të Trupit Gjykes mbi pafajësinë ose fajësinë e të akuzuarit.

Më 4 mars, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen *Pjetër Shala* caktoi 31 majin si datën e mundshme për kalimin e dosjes së çështjes Trupit Gjykes.

Më datën 24 mars, në orën 14:30 është planifikuar seanca e ardhshme e procedurës paraprake kundër z. Thaçi dhe të bashkakuzuarve.

Ndër lajme të tjera: këtë javë ekipi i programit për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së u takua me studentët e juridikut në Mitrovicën e Veriut, studentët e juridikut në Fushë Kosovë dhe Lipjan në Prishtinë, me nxënësit e shkollës së mesme të mjekësisë në Prishtinë, nxënësit e shkollës së mesme në Pejë si dhe me komunitetet në Novobërdë dhe Shillovë.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

